

VENDIM
Nr.418, datë 9.6.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.412, DATË 15.9.1992 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR DHËNIEN E
LICENCEVE PROFESIONALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.412, datë 15.9.1992 të Këshillit të Ministrave, të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Dhënia e licencave profesionale në fushën e shërbimeve publike, me karakter vendor, për:

- shërbimin për administrimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe inerte;
- shërbimin për administrimin e parqeve, të lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike;
- shërbimin për administrimin e varrezave publike dhe të dëshmorëve;
- shërbimin publik të varrimit;
- shërbimin e dekorit,

të bëhet nga komisionet e posaçme për dhënie e licencave profesionale, të ngritura pranë bashkive dhe komunave. Kriteret e procedurat e dhënies së këtyre licencave e të funksionimit të komisioneve përkatëse miratohen nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit dhe nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit .”.

2. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe bashkitë e komunat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano